

## **Dhomat e Specializuara të Kosovës – Konkursi i Eseve 2022**

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) kanë kënaqësinë të shpallin konkursin e eseve për studentët e drejtësisë.

Të gjithë studentët e interesuar nga universitetet publike ose private të Kosovës ftohen të paraqesin esetë e tyre deri më 30 nëntor 2022.

Esetë do të shqyrtohen nga një komision, pjesë e të cilit janë ekspertë të fushës së të drejtës ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit do të njoftohen me email për rezultatet e konkursit. Studentët me tre esetë më të mira do të shpërblehen me libra nga fusha e të drejtës ndërkombëtare me një vlerë prej rreth 250 euro.

Të gjithë studentët e interesuar duhet të lexojnë me kujdes rregullat e mëposhtme në mënyrë që eseja e tyre të pranohet në konkurs.

### **Rregullat e konkursit të eseve të DHSK-së**

#### ***Kriteret e pranimit***

- Studentët e drejtësisë duhet të jenë të regjistruar në një universitet në Kosovë në nivel universitar ose pasuniversitar.

#### ***Tema***

- Studentët mund ta zgjedhin vetë temën, me kusht që ajo të jetë nga fusha e drejtësisë dhe të ketë lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës.
- Shembuj të temave të mundshme janë:
  - vendimet/qasja e gjykatësve dhe paneleve të gjykatësve të Dhomave të Specializuara (d.m.th. jurisprudenca);
  - krahasimet me vendimet/jurisprudencën e gjykatave të tjera;
  - temat që kanë lidhje me kornizën ligjore të DHSK-së.
- Tema e zgjedhur në ese duhet të paraqitet në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur nga këndvështrimi juridik. Ju lutemi të shmangni temat spekulative.

#### ***Udhëzime për dorëzimin e eseve***

- Do të pranohen dhe vlerësohen vetëm punimet akademike të cilësisë së lartë. Autor i punimit duhet të jeni ju vetë. Më shumë informacion mbi integritetin akademik do të gjeni [këtu](#).
- Punimet do të vlerësohen në bazë të origjinalitetit të ideve, qartësisë së paraqitjes dhe shprehjes, argumentimit bindës dhe faktorëve gjuhësorë si sintaksa, gramatika, drejtshkrimi dhe lexueshmëria në përgjithësi.

- Punimet duhet të përmbajnë referenca dhe bibliografi. Gjatësia e tekstit kryesor duhet të jetë midis minimum 1500 dhe maksimum 4000 fjalë, duke përjashtuar referencat dhe bibliografinë.
- Lloji i shkrimit në punim duhet të jetë *Times New Roman*, 12 points, 2 line spacing. Punimi duhet të ketë një faqe të veçantë për titullin, e cila duhet të përmbajë titullin e esesë, emrin e autorit dhe numrin e fjalëve.
- Esetë duhet të dorëzohen në një të një nga tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës (shqipe, serbishte ose anglishte).
- Esetë duhet të dorëzohen në formatin *MS Word* dhe *PDF*. Versione të tjera nuk do të pranohen.
- Esetë duhet të dërgohen në [PICU@scp-ks.org](mailto:PICU@scp-ks.org), duke shënuar “*Essay Competition*” në titullin e email-it.
- Në tekstin e email-it duhet të shënoni emrin tuaj, emrin e universitetit, fakultetin dhe studimet që ndiqni.
- Së bashku me esenë duhet të dorëzoni edhe një [Formular Autorizimi](#) të plotësuar dhe të nënshkruar, me të cilin jepni pëlqimin tuaj për përpunimin e të dhënave personale për administrimin e konkursit.

### ***Afati***

- Afati i fundit për dorëzimin e eseve është data 30 nëntor 2022, ora 23:59.

Me dorëzimin e esesë, pjesëmarrësit konfirmojnë se janë të vetëdijshëm se esetë që nuk janë në përputhje me udhëzimet e mësipërme mund të skualifikohen.

### **Çmimet**

Studentët me tre esetë më të mira do të shpërblehen me libra nga fusha e të drejtës ndërkombëtare me një vlerë prej deri 250 euro.

Për çdo sqarim në lidhje me konkursin e eseve, dërgoni email me pyetjen tuaj në [PICU@scp-ks.org](mailto:PICU@scp-ks.org).

### ***Njoftimi i privatësisë***

Deklarata e Privatësisë e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së gjendet [këtu](#).